

Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2020

Për

RASTET DHE MËNYRA E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET PUSHTETIT QENDROR DHE NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE PËR KRIJIMIN OSE SHTIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i:
 - a. rasteve të bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose/dhe shtimin e fondit publik të banesave sociale dhe,
 - b. mënyrës së bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për këtë qëllim.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë regjistrin e fondit të banesave sociale në pronësinë e tyre që përdoren për t'u dhënë me qira. Për çdo banesë sociale regjistri përmban:
 - a) informacionin gjeohapësinor të vendndodhjes së banesave,
 - b) plan-vendosjen e tyre,
 - c) planimetrinë e apartamenteve,
 - ç) informacion mbi gjendjen teknike të çdo apartamenti,
 - d) vlerën e investimit fillestar,
 - dh) vlerën e investuar për rehabilitimin ose rinovimin e tyre,
 - e) vitin kur ka përfunduar ndërtimi,
 - ë) vitin kur janë bërë punimet e rinovimit,
 - f) subjektin që është ngarkuar ose kontraktuar për menaxhimin e tyre.

3. Në një faqe të posacme të regjistrit të fondit të banesave sociale hidhen të dhënat për banesat sociale në pronësi të Entit Kombëtar të Banësive (EKB) ose të subjekteve të tjera publike që përdoren për t'u dhënë me qira. EKB dhe subjektet e tjera publike që disponojnë banesa sociale me qira, detyrohen të dërgojnë informacionin sipas pikës 2 të këtij vendimi në njësitë e vetëqeverisjes vendore në territorin e të cilave ndodhen këto banesa. Krahas informacionit të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi për banesat në pronësi të EKB evidentohen edhe të dhënat që lidhen me mënyrën administrative të vënies në dispozicion të strehimit social të këtyre banesave si dhe kushtet e kalimit të së drejtës së përdorimit të tyre, afatin e përdorimit si banesa sociale, etj. Këto banesa vazhdojnë të mbeten në pronësi

EKB dhe nuk bëhen pjesë e fondit publik të banesave sociale që janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore.

4. Në një faqe të posacme të regjistrimit të fondit të banesave sociale hidhen të dhënat për banesat në pronësi të pronarit social, për aq kohë sa ato janë në përdorim si banesa sociale me qira vetëm për efekt të evidentimit të qëllimit të tyre dhe lehtësimit të menaxhimit e mbikqyrjes së kontratës së qirasë, për të cilën paguhet subvencioni nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nga buxheti i shtetit ose nga të dyja bashkë. Krahas informacionit të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi për banesat në pronësi të pronarit social evidentohen edhe të dhënat që lidhen me kontratën e lidhur me pronarin e tyre dhe kushtet kryesore kontraktore të tilla si afati, vlera e qirasë, etj. Këto banesa vazhdojnë të mbeten në pronësi private të pronarit social dhe nuk bëhen pjesë e fondit publik të banesave sociale që janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore.
5. Fondi publik i banesave sociale krijohet dhe/ose shtohet në njëërën ose kombinimin e dy ose më shumë formave të mëposhtëme:
 - a) ndërtime të reja,
 - b) blerje banesash nga tregu,
 - c) përshtatjen e objekteve ekzistuese me funksion jo banimi,
 - ç) aparatmente të siguruara nga kontributi i sektorit privat, sipas nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social",
 - d) aparatmentet e përfuara nga partneriteti me sektorin privat,
 - dh) dhurimi i banesave me kontratë nga subjekte publike ose private, vendase ose të huaja, të cilat kalojnë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për t'u përdorur si banesa sociale me qira si pjesë e fondit publik të banesave sociale,
 - e) pronat e konfiskuara, si pasuri të vëna gjatë aktivitetit kriminal dhe që kalojnë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas procedurave ligjore përkatëse, ë) blerja e banesave pas ankandit të parë të banesave që shiten sipas parashikimeve të nenit 557 të Kodit të Procedurës Civile.
6. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, mbështetur në programet 5-vjeçare të strehimit social dhe në nevojat e identifikuar nga aplikimet për strehim, planifikojnë fondet nga të ardhurat e tyre, si dhe nevojat që kanë për financime nga buxheti i shtetit për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale dhe për rritjen e tij.
7. Ministria përgjegjëse për strehimin, mbështet me financime njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale dhe për mirëmbajtjen e tyre në përputhje me kërkesat e njësive të vetëqeverisjes vendore.
8. Ministria përgjegjëse për strehimin monitoron procesin e krijimit dhe shtimit të fondit publik të banesave sociale dhe të fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit për këtë qëllim. Monitorimi i përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit të akorduara për krijimin ose/dhe shtimin e fondit publik të banesave sociale, bëhet nga struktura përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin. Monitorimi përfshin:

- a. verifikimin e përmbushjes së qëllimit të përdorimit të fondit nga buxheti i shtetit të dedikuar për krijimin ose/dhe shtimin e fondit publik të banesave sociale;
 - b. mbikëqyrjen e hapave ligjorë me qëllim administrimin e këtyre fondeve;
 - c. mbikëqyrjen e procedurave që lidhen me ndërtimin, me blerjen ose dhurimin e banesave që bëhen pjesë e fondit publik të banesave sociale.
9. Njësitë e vetëqeverisjes vendore raportojnë brenda muajit dhjetor të çdo viti mbi numrin e banesave sociale të regjistruara në regjistrin vendor dhe formën e sigurimit të tyre edhe kur ato janë siguruar vetëm me të ardhurat e njësisve të vetëqeverisjes vendore, me anë të dhurimit ose me forma të tjera të parashikuara në pikën 5 të këtij vendimi.
10. Ngarkohen Ministria përgjegjëse për strehimin dhe njësitë e qeverisjes vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN "RASTET DHE MËNYRA E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET PUSHTETIT QENDROR DHE NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE PËR KRIJIMIN OSE SHTIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi "Rastet dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale" propozohet në zbatim të nenit 18, pika 2 të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", me qëllim evidentimin e rasteve të bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose/dhe shtimin e fondit publik të banesave sociale dhe përcaktimin e mënyrës së bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për këtë qëllim.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është në përputhje të plotë me ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", dhe programin politik të Këshillit të Ministrave për sa i përket politikës ekonomiko-sociale të shtetit shqiptar.

Projektvendimi është i parashikuar në programin analitik të projektakteve për vitin 2019 miratuar me VKM Nr. 764, datë 27.12.2018 "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019", në pikën me titull "Rastet dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale". Projektakti është planifikuar të miratohet në katërmujorin e tretë dhe çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti lidhen me modalitetet dhe veprimet që kryhen në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin e fondit publik të banesave sociale ose shtimin e tij, si dhe me parashikimet që lidhen me mënyrën e krijimit të regjistrit të këtij fondi dhe evidentimin e pasurive dhe banesave që do të jenë në inventarin e këtij regjistri.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi "Rastet dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale" është një propozim i bazuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", përkatësisht në nenin 18, pika 2 të tij. Efektet e pritshme të këtij projektvendimi janë të lidhura me politikën sociale të shtetit shqiptar dhe synon përcaktimin e formës dhe mënyrës së bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore për krijimin e fondit publik të banesave sociale ose shtimin e tij, si dhe me parashikimet që lidhen me mënyrën e krijimit të regjistrit të këtij fondi dhe evidentimin e pasurive dhe banesave që do të jenë në inventarin e këtij regjistri.

Projektvendimi synon të japë format dhe burimet e krijimit të fondit publik të banesave sociale si dhe elementët teknikë të nevojshëm për krijimin e tij ose për shtimin e banesave të reja në përbërje të këtij fondi. Po ashtu, projektvendimi përcakton edhe mënyrën e monitorimit nga ministria përgjegjëse për strehimin të përdorimit të fondeve nga buxheti i shtetit që do të jenë burim i shtimit të fondit publik të banesave sociale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 118 të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social".

- a) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me nenin 100, pikën 1 dhe pikën 2 të nenit 118 të Kushtetutës.* Akti është propozuar nga një organ kushtetues (Ministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë) përpara një organi kushtetues (Këshilli i Ministrave), i cili ka kompetencën të miratojë këtë akt (neni 100 i Kushtetutës). Akti i propozuar ka si pasojë juridike përcaktimin e procedurave të administrimit dhe mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme të nevojshme për grupe të shoqërisë që gjenden në një situatë të një nevoje të papritur për strehim dhe të qartësojë kompetencat e subjekteve përgjegjëse dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre me qëllim administrimin dhe mirëmbajtjen e strehëve të përkohshme.

Bazuar në nenin 18, pika 2 të ligjit nr. 22/2018, jemi në kushtet e plotësimit të kërkesave kushtetuese të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës për nxjerrjen e akteve nënligjore për arsye se: (i) ligji material përcakton organin publik i cili ka tagrin të urdhërojë nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor (Këshilli i Ministrave), (ii) ligji, i cili shërben si bazë ligjore e aktit të propozuar, autorizon në mënyrë të shprehur nxjerrjen e aktit nënligjor (iii) ligji parashikon çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret akti i propozuar.

- b) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me qëllimin e dispozitës përkatëse të ligjit, në funksion të propozimit.* Ligji për strehimin social ka të përcaktuara edhe modalitetet që duhet të plotësojë akti sa i takon qëllimit të propozimit. Konkretisht, neni 18, pika 2 e ligjit nr. 22/2018 parashikon se: "2. Rastet dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njërive të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. "
- c) *Përputhshmëria e aktit me legjislacionin ndërkombëtar.* Akti nuk lidhet drejtpërdrejt me ndonjë akt ndërkombëtar.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka si objektiv të përafrohet me ndonjë akt ligjor të BE-së.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi propozohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të zbatimit të politikës së qeverisë shqiptare në fushën e strehimit social, me qëllim përcaktimin e rasteve të bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njërive të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose/dhe shtimin e fondit publik të banesave sociale dhe përcaktimin e mënyrës së bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njërive të vetëqeverisjes vendore për këtë qëllim.

Projektvendimi është i strukturuar në 10 pika. Në pikën 1 përcaktohet qëllimi i këtij projektvendimi që lidhet me banesave sociale dhe me rastet e mënyrën e bashkëpunimit midis pushtetit qendror dhe njërive të vetëqeverisjes vendore.

Në pikën 2 parashikohet detyrimi i njërive të vetëqeverisjes vendore për të krijuar regjistrin e fondit të banesave sociale që përdoren për t'u dhënë me qira në pronësinë e tyre. Në këtë pikë parashikohen edhe të hënat kryesore që do të evidentohen në regjistrin për çdo pronë që është pjesë e fondit publik të banesave sociale, duke filluar me informacionin gjeohapësinor të vendndodhjes së banesave, plan-vendosjen e tyre, planimetrinë e apartamenteve, informacion mbi gjendjen teknike të çdo apartamenti dhe duke vijuar me vlerën e investimit fillestar, vlerën e investuar për rehabilitimin ose rinovimin e tyre, vitin kur ka përfunduar ndërtimi ose kur janë bërë punimet e rinovimit, si dhe subjektin që është ngarkuar ose kontraktuar për menaxhimin e tyre.

Në vijim të vendimit në pikat 3 dhe 4 parashikohen në vazhdim të njera tjetrës edhe dy faqe të posaçme të regjistrit që lidhen me banesat në pronësi të EKB-së dhe banesat në pronësi të pronarëve socialë. Qëllimi i evidentimit në regjistrin e banesave sociale të dy kategorive të pronave që nuk janë në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore është që të ketë një faqe të regjistrit që

të ecidnetojë banesat që jepen me qira sociale dhe I bashkophen fondit për një kohëzgjatje të përkohshme pa e zhveshur pronarin e tyre nga e drejta e pronësisë. Meqënëse e drejta e përdorimit të një sendi me qëllim banimin është një e drejtë reale që shoqëron sendin, ky regjistër është mirë të evidnetojë edhe pronat që njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë në dispozicion të ytre për t'i përdorur si banesa sociale me qira, mbështetur në kontratat e lidhura me pronarët e tyre. Për këto banesa krahas të dhënave të kërkuara për fondin publik do të evidentohen edhe të dhënat që lidhen me kontratën e lidhur me pronarin e tyre dhe kushtet kryesore kontraktore të tilla si afati, vlera e qirasë, etj. Këto banesa vazhdojnë të mbeten në pronësi private të pronarit social ose EKB dhe nuk bëhen pjesë e fondit publik të banesave sociale që janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në pikën 5 trajtohen format e krijimit apo të shtimit të fondit publik të banesave sociale, kryesisht me ndërtime të reja, me blerje banesash nga tregu, me përshtatjen e objekteve ekzistuese me funksion jo banimi, me përfitim të aparatmenteve të siguruara nga kontributi i sektorit privat, sipas nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" dhe nga partneriteti me sektorin privat, me pronat e konfiskuara, si pasuri të vëna gjatë aktivitetit kriminal dhe që kalojnë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas procedurave ligjore përkatëse, me blerjen e banesave pas ankandit të parë të banesave që shiten sipas parashikimeve të nenit 557 të Kodit të Procedurës Civile. Nisur nga disa raste të donacioneve dhe dhurimeve të ofruara nga subjekte private pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019, në radhën e burimeve me të cilat shtohet fondi publik i banesave u parashikua edhe dhurimi i banesave me kontratë nga subjekte publike ose private, vendase ose të huaja, të cilat kalojnë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për t'u përdorur si banesa sociale me qira si pjesë e fondit publik të banesave sociale.

Në pikën 6 parashikohet detyrimi i njësive të vetëqeverisjes vendore, planifikojnë fondet nga të ardhurat e tyre, si dhe nevojat që kanë për financime nga buxheti i shtetit për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale dhe për rritjen e tij, mbështetur në programet 5 vjecare të strehimit social dhe në nevojat e identifikuar nga aplikimet për strehim.

Npë pikat 6 deri në 8 trajtohet roli i ministrisë përgjegjëse për strehimin në bashkëpunimin e saj me pushtetin vendor për shtimin dhe krijimin e fondit. Ministria përgjegjëse për strehimin, mbështet me financime njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale dhe për mirëmbajtjen e tyre në përputhje me kërkesat e njësive të vetëqeverisjes vendore. Nga ana tjetër, në pikën 7 parashikohet detyra e ministrisë përgjegjëse për strehimin për të monitoruar procesin e krijimit dhe shtimit të fondit publik të banesave sociale dhe të fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit për këtë qëllim. Monitorimi i përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit të akorduara për krijimin ose/dhe shtimin e fondit publik të banesave sociale, bëhet nga struktura përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin. Pika 8 e projektvendimit shpjegon listën e veprimeve që duhet të kryhen në kuadër të monitorimit të tilla si: verifikimi i përmbushjes së qëllimit të përdorimit të fondit nga buxheti i shtetit të dedikuar për krijimin ose/dhe shtimin e fondit publik të banesave sociale, mbikëqyrjen e hapave ligjorë me

qëllim administrimin e këtyre fondeve, si dhe mbikqyrjen e procedurave që lidhen me ndërtimin, me blerjen ose dhurimin e banesave që bëhen pjesë e fondit publik të banesave sociale.

Në pikën 9 projektvendimi konkludon me detyrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore që të raportojnë brenda muajit dhjetor të çdo viti mbi numrin e banesave sociale të regjistruara në regjistrin vendor dhe formën e sigurimit të tyre edhe kur ato janë siguruar vetëm me të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore, me anë të dhurimit ose me forma të tjera të parashikuara nga ky vendim.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektvendimi, sipas pikës 10 të projektvendimit, ngarkohen Ministria përgjegjëse për strehimin dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projekt vendim u hartua në kuadrin e një bashkëpunimi midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) si ministria përgjegjëse për strehimin dhe UNDP-së e Këshillit të Europës, me asistencën e ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Ekspertët kombëtarë u kontraktuan nga UNDP-ja mbështetur në procedurat e UNDP-së.

Pranë MFE-së u ngrit grupi i punës me anëtarë nga stafi i MFE-së dhe në bashkëpunim me specialistët, ekspertët dhe drejtuesit e Entit Kombëtar të Banesave, si dhe me konsulencën e ekspertëve, të cilët në takime të vazhdueshme dhe periodike diskutuan lidhur me metodologjinë e punës dhe të bashkëpunimit për të vlerësuar situatën aktuale, ligjore dhe faktike të bashkëpunimit ndërinstitucional me njësitë e vetëqeverisjes vendore për marrjen e ofndeve nga buxheti i shtetit. Draftet e përgatitur nga ekspertë u rishikuan disa here në takime të përbashkëta të grupit të punës për të pasqyruar në to çdo problematikë të ndeshur në praktikën e deritanishme. Grupi i punës dhe ekspertët analizuan edhe aktet nënligjore përkatëse që kanë mbuluar rregullimet e këtij projektvendimi për të konstatuar nga pikëpamja historike evoluimin e rregullimit ligjor.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social" përcjell kosto shtesë financiare për të gjitha programet, një pjesë e të cilave do të përballohen nga buxheti qendror dhe nga buxheti i njësisve të vetëqeverisjes vendore. Specifikisht për këtë akt nuk mbarten kosto financiare shtesë.

Lidhur me kostot institucionale, projektvendimi kërkon përcatim të strukturës përgjegjëse për strehimin në njësitë e vetëqeverisjes vendore, e cila do të angazhohet me realizimin e administrimit dhe mirëmbajtjes apo mbikqyrjen e këtij procesi për strehët e përkoshme.

PROPOZUESI

MINISTRI

VENDIM
Nr....., datë2019

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, KRITERET DHE PROCEDURAT E
PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË STREHIMIT, SI
DHE MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA SHTETËRORE QË
VEPROJNË NË KËTË FUSHË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 71, pika 5 të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Strehimit (KKS) është organ këshillimor, pranë Kryeministrit, që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për strehimin.
2. KKS, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Ministrisë përgjegjëse për strehimin, këshillon për:
 - a) linjat kryesore të ndërhyrjes në sektorin e strehimit, sipas objektivave të përcaktuar nga politika e strehimit dhe programet ekonomike kombëtare;
 - b) plotësimin e nevojave parësore për strehim;
 - c) kriteret e ndarjes së burimeve të financimit për programet sociale të strehimit, sipas këtij ligji;
 - ç) programet kombëtare 5-vjeçare të strehimit që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe për rishikimin eventual të tyre.
3. KKS kryesohet nga ministri përgjegjës për strehimin dhe në përbërje të tij ka 7 (shtatë) anëtarë, si vijon:
 - a) 2 (dy) janë anëtarë të ministrisë përgjegjëse për strehimin, një prej të cilëve sipas përcaktimit në Urdhër të Kryeministrit, ushtron detyrën e nënkryetarit;
 - b) 1 (një) anëtar nga Ministria përgjegjëse për çështjet sociale,
 - c) 1 (një) anëtar nga Ministria përgjegjëse për çështjet vendore,
 - ç) 1 (një) anëtar përfaqësues nga grupet e interesit dhe shoqëria civile, dhe
 - d) 1 (një) anëtar nga shoqatat përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore.
4. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Strehimin është 4 (katër) vjet, me të drejtë riemërimi. Ata përzgjidhen nga:
 - a) nëpunësit apo funksionarët politikë të ministrive;
 - b) organet ekzekutive të njësive të vetëqeverisjes vendore;
 - c) anëtarë të angazhuar në organizatat e shoqërisë civile, objekti i veprimtarisë së të cilave është i ndërlidhur me fushën e strehimit.
5. Ministria përgjegjëse për strehimin sa herë që krijohet një vend i lirë në anëtarësinë e KKS-së, kërkon nga strukturat përkatëse caktimin e anëtarit përfaqësues. Kërkesa për rastet e njësive të vetëqeverisjes vendore ose organizatave të shoqërisë civile shpallet në faqen zyrtare on line të ministrisë përgjegjëse për strehimin si dhe të Kryeministrisë, duke përcaktuar edhe afatin për

paraqitjen e kandidaturave. Ministri përgjegjës për strehimin bën një vlerësim të kandidaturave në rastet kur nga një subjekt i përfaqësuar paraqiten më shumë se 1 (një) kandidaturë, dhe ia paraqet atë Kryeministrit që emërohen anëtarin e KKS. Vlerësimi bazohet në këto kritere:

- a) eksperiencia në fushën e strehimit,
- b) eksperiencia në administrim dhe politika publike,
- c) përvoja në projekte, studime, botime dhe veprimtari sociale në fushën e mbështetjes së grupeve të ndryshme sociale,
- ç) gjinia më pak e përfaqësuar në KKS.

6. Në ndihmë të KKS-së krijohet sekretaria teknike e përbërë nga një specialist, pranë Ministrisë përgjegjëse për strehimin. Specialisti i sekretarisë teknike luan rolin e sekretarit të mbledhjeve të KKS.

7. KKS kryesohet nga kryetari, dhe në mungesë të tij, nga zëvendëskryetari i KKS-së. Kryetari thëret mbledhjet e KKS-së, miraton rendin e ditës të propozuar nga sekretari i KKS-së dhe drejton mbledhjet e KKS-së.

8. Mbledhjet e KKS-së, si rregull mbahen 1 (një) herë në tre muaj, e të paktën 2 (dy) herë në vit. Me kërkesë të kryetarit ose njërit prej anëtarëve, KKS mund të mbledhet edhe jashtë radhe. Të paktën 5 (pesë) ditë përpara datës të zhvillimit të mbledhjes, sekretariati i KKS-së njofton anëtarët e KKS-së për datën, orën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, agjendën e saj si dhe shpërndan materialet që do të shqyrtohen në mbledhje nga KKS.

9. KKS i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

10. Në mbledhjet e KKS-së ftohen të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe përfaqësues të njësisive të vetëqeverisjes vendore, të sektorit privat, organizata joqeveritare, institucione financiare dhe përfaqësues të komunitetit, sipas përcaktimit nga Kryetari apo kërkesës së secilit prej anëtarëve të KKS-së.

11. KKS miraton, me votën pro të më shumë se gjysmës së të pranishmëve në mbledhje, rekomandime, të cilat zbardhen si të tilla dhe firmosen nga kryetari. Anëtarët e KKS-së nuk kanë të drejtë të abstenojnë në votime në asnjë rast.

12. Kryetari i KKS-së është përfaqësuesi i KKS-së në marrëdhënie me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë apo subjekte të tjera. Kryetari i raporton çdo vit Kryeministrit për veprimtarinë e KKS-së dhe sa herë kërkohet nga Kryeministri. KKS-ja, në rastet kur Kryetari është në pamundësi përfaqësimi, cakton përfaqësues nga radhët e anëtarëve të vet për ta përfaqësuar në marrëdhëniet me të tretët.

13. Kryetari informon me shkrim për rekomandimet e miratuara nga KKS-ja Kryeministrin, institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë apo fusha të ndërlidhura me strehimin, Prefektët dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo subjekt tjetër publik që ushtron veprimtari në fushën e strehimit.

14. Anëtarët e KKS-së kanë për detyrë të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet që zhvillon KKS-ja.

Anëtarët e KKS-së nuk mund të përfaqësohen me delegim apo zëvendësohen në mbledhjet e KKS-së. Çdo anëtar mban komunikimin me sekretariatit e KKS-së për të siguruar çdo informacion të nevojshëm lidhur me mbledhjet dhe veprimtarinë e KKS-së, si dhe siguron nga institucioni apo subjekti që përfaqëson çdo informacion të nevojshëm mbi çështjet që kërkohen nga KKS.

15. Sekretaria teknike e KKS-së ka për detyrë të:

- a) njoftojë anëtarët për datën, vendin dhe orën e caktuar të mbledhjes së radhës së KKS-së;
- b) përgatisë materialin e mbledhjes dhe, pas miratimit nga Kryetari i KKS-së, t'ua shpërndajë atë anëtarëve, të paktën 5 ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes;
- c) mbajë procesverbalin e mbledhjes dhe të sigurojë firmosjen e tij nga çdo anëtar. Procesverbali firmoset edhe nga sekretari;
- ç) përgatisë raportin e mbledhjes dhe t'ia paraqesë atë për miratim kryetarit;
- d) zbardhë rekomandimet e miratuara në mbledhjet e KKS-së;
- dh) paraqesë pranë kryetarit çështje, të cilat kanë nevojë për t'u adresuar nga KKS-ja.

16. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Strehimit shpërblehen, për çdo pjesëmarrje në mbledhje në përputhje me legjislacionin në fuqi. Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të KKS përballohen nga buxheti i shtetit.

17. Ngarkohet Kryeministri, Prefektët, ministri përgjegjës për strehimin, çështjet sociale dhe për çështjet vendore, si dhe shoqatat përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË STREHIMIT, SI DHE MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA SHPETËRORE QË VEPROJNË NË KËTË FUSHË

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi "Për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit, si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë" propozohet në zbatim të nenit 71, pika 5 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", me qëllim që të përcaktojë rregulla të hollësishme për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është në përputhje të plotë me ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", dhe programin politik të Këshillit të Ministrave për sa i përket politikës ekonomiko-sociale të shtetit shqiptar.

Projektvendimi është i parashikuar në programin analitik të projektakteve për vitin 2019 miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 764, datë 27.12.2018 "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019", përkatësisht në pikën me titull "[p]ër rregullat e hollësishme për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë". Projektakti në referim të nenit 71, pika 5 të ligjit nr. 22/2018 është planifikuar të miratohet në katërmujorin e tretë të vitit 2019 dhe çështja kryesore që parashikon të rregullojë projektakti është përcaktimi i rregullave të hollësishme për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë.

Gjithashtu, projektakti plotëson kuadrin ligjor të kërkuar nga Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 miratuar me Vendimin nr. 405, datë 01.06.2016, të Këshillit të Ministrave. Kjo Strategji nxori në pah situatën reale të strehimit, identifikoi nevojat për të mbështetur këtë sektor në kushtet e reja të reformës administrative-territoriale si dhe diktoi nevojën e një kuadri ligjor të ri.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" është një propozim i bazuar në ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social", përkatësisht në nenin 71, pika 5 të tij. Projektvendimi qartëson se qëllimi i tij është që të përcaktojë rregulla të hollësishme për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë. Në vijim të projektakteve të tjera zbatuese të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", projektakti plotëson kuadrin ligjor të nevojshëm për zbatimin e ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" dhe plotëson kuadrin institucional politikëbërës për çështjet e strehimit social.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 118 të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social".

- a) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me nenin 100, pikën 1 dhe pikën 2 të nenit 118 të Kushtetutës:* Akti i propozuar propozohet nga një organ kushtetues (Ministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë) përpara një organi kushtetues (Këshilli i Ministrave), i cili ka tagrin të miratojë këtë akt (neni 100 i Kushtetutës). Bazuar në nenin 71, pika 5 të ligjit 22/2018, jemi në kushtet e plotësimit të kërkesave kushtetuese të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës për nxjerrjen e akteve nënligjore për arsye se: (i) ligji material përcakton organin publik i cili ka tagrin të urdhërojë nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor (Këshilli i Ministrave), (ii) ligji i cili shërben si bazë ligjore e aktit të propozuar autorizon në mënyrë të shprehur nxjerrjen e aktit nënligjor (iii) ligji parashikon çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret akti i propozuar.
- b) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me qëllimin e dispozitës përkatëse të ligjit, në funksion të propozimit:* Ligji për strehimin social ka të përcaktuara qartë edhe modalitetet që duhet të plotësojë akti sa i takon qëllimit të propozimit. Konkretisht, neni 71, pika 5 të ligjit nr. 22/2018 parashikon se "[r]regulla të hollësishme për organizimin, funksionimin, kriteret

dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit, si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Çështjet e këtyre neneve adresohen plotësisht në titull dhe në përmbajtjen e projektaktit.

- c) Bazuar në këtë parashikim të ligjit, Ministri i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë që është përgjegjëse për strehimin propozon aktin përpara organit që ligji ka autorizuar, Këshillit të Ministrave.
- d) *Përputhshmëria e aktit me legjislacionin ndërkombëtar*: Akti nuk lidhet drejtpërdrejt me ndonjë akt ndërkombëtar, por në kuadrin e përgjithshëm është përgatitur në përputhje me Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut (neni 25/1); Konventën për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 17 i ICCPR, 1966); Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (neni 9 dhe 28 të CRPD, 2006); Konventën lidhur me statusin e refugjatit (neni 21, CRSR, 1951); Konventën “Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre” 1990 (neni 43 (1)(d); Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe veçanërisht neni 11/1 i saj: Rekomandimet e Përgjithshme 4 (1991) dhe 7 (1997) të cilët i dedikohen strehimit të përshtatshëm dhe Rekomandimi i Përgjithshëm 16 (paragrafi 28 mbi të drejtat e grave për strehim adekuat) të Komitetit, që vepron në kuadrin e kësaj konvente të lidhura ngushtë me këtë të drejtë. Konventën Europiane për Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë (1977); Kartën Sociale Europiane (1961); Kartën Sociale Europiane e Rishikuar (1996) dhe Konventën Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, (KEDNJ, 1950).

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka si objektiv të përafrohet me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi propozohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë në kuadër të zbatimit të politikës së qeverisë shqiptare në fushën e strehimit social, me qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë.

Projektvendimi është i strukturuar në 17 pika. Në përputhje me ligjin për strehimin social si dhe në respektim të fushës së përgjegjësisë të ministrive, pika 1 dhe 2 qartësojnë se Këshilli Kombëtar

dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit, si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Çështjet e këtyre neneve adresohen plotësisht në titull dhe në përmbajtjen e projektaktit.

- c) Bazuar në këtë parashikim të ligjit, Ministri i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë që është përgjegjëse për strehimin propozon aktin përpara organit që ligji ka autorizuar, Këshillit të Ministrave.
- d) *Përputhshmëria e aktit me legjislacionin ndërkombëtar*: Akti nuk lidhet drejtpërdrejt me ndonjë akt ndërkombëtar, por në kuadrin e përgjithshëm është përgatitur në përputhje me Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 25/1); Konventën për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 17 i ICCPR, 1966); Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (neni 9 dhe 28 të CRPD, 2006); Konventën lidhur me statusin e refugjatit (neni 21, CRSR, 1951); Konventën “Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre” 1990 (neni 43 (1)(d); Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe veçanërisht neni 11/1 i saj; Rekomandimet e Përgjithshme 4 (1991) dhe 7 (1997) të cilët i dedikohen strehimit të përshtatshëm dhe Rekomandimi i Përgjithshëm 16 (paragrafi 28 mbi të drejtat e grave për strehim adekuat) të Komitetit, që vepron në kuadrin e kësaj konvente të lidhura ngushtë me këtë të drejtë. Konventën Europiane për Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë (1977); Kartën Sociale Europiane (1961); Kartën Sociale Europiane e Rishikuar (1996) dhe Konventën Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, (KEDNJ, 1950).

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka si objektiv të përafrohet me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi propozohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë në kuadër të zbatimit të politikës së qeverisë shqiptare në fushën e strehimit social, me qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë.

Projektvendimi është i strukturuar në 17 pika. Në përputhje me ligjin për strehimin social si dhe në respektim të fushës së përgjegjësive të ministrive, pika 1 dhe 2 qartësojnë se Këshilli Kombëtar

i Strehimit (KKS) është organ këshillimor, pranë Kryeministrit, që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për strehimin, si dhe çështjet kyçe për të cilat KKS këshillon: linjat kryesore të ndërhyrjes në sektorin e strehimit, sipas objektivave të përcaktuar nga politika e strehimit dhe programet ekonomike kombëtare, plotësimin e nevojave parësore për strehim, kriteret e ndarjes së burimeve të financimit për programet sociale të strehimit, sipas këtij ligji, programet kombëtare 5-vjeçare të strehimit që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe për rishikimin eventual të tyre.

Pika 3 përcakton përbërjen e KKS, me kryetar ministrin përgjegjës për strehimin, duke synuar një përbërje sa më përfaqësuese, përfshirë edhe shoqërinë civile, dhe në përbërje të tij ka 7 (shtatë) anëtarë, si vijon:

- 2 (dy) janë anëtarë të ministrisë përgjegjëse për strehimin, një prej të cilëve sipas përcaktimit në Urdhrin e Kreministrit, ushtron detyrën e nënkryetarit;
- 1 (një) anëtar nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale,
- 1 (një) anëtar nga ministria përgjegjëse për çështjet vendore,
- 1 (një) anëtar përfaqësues nga grupet e interesit dhe shoqëria civile, dhe
- 1 (një) anëtar nga shoqatat përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore.

Duke qenë se KKS është organ kolgjial, projektvendimi, në pikat 4 deri 16, parashikon një sërë rregullash të funksionimit, si: rregulla për mandatin e anëtarëve të KKS 4 vjet, me të drejtë riemërimi dhe rregulla të komunikimit institucional dhe njoftimit publik nga ministria përgjegjëse për strehimin sa herë që krijohet një vend i lirë në anëtarësinë e KKS-së dhe vlerësimit të kandidaturave për emërim nga Kryeministria në bazë të kriterëve të formimit, aftësive profesionale dhe barazisë gjinore, rregulla për sekretarinë teknike të KKS, rolin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KKS-së, pamundësinë e përfaqësimit me delegim apo zëvendësohen në mbledhje, thirrjen e mbledhjes një herë në tre muaj e të paktën dy herë në vit mbajtjen, dhe njoftimin e agjendës së mbledhjes të paktën pesë ditë përpara datës të zhvillimit të saj, rregulla për kuorumin e mbledhjes së KKS-së, me të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij, kuorumin e vendimmarrjes me më shumë se gjysmën e të pranishmëve në mbledhje, detyrimin për pjesëmarrje në mbledhje dhe pamundësinë e anëtarëve të KKS-së për të abstenuar, shpërblimin për çdo pjesëmarrje në mbledhje në përputhje me legjislacionin në fuqi, efekte të cilat përballohen nga buxheti i shtetit. Të gjitha këto rregulla janë edhe në respektim të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike". Po ashtu, në këto pika parashikohen rregulla të llogaridhënies si raportimi çdo vit pranë Kryeministrit për veprimtarinë e KKS-së dhe sa herë kërkohet nga Kryeministri, detyrimin e kryetarit që të informojë me shkrim për rekomandimet e miratuara nga KKS-ja Kryeministrin, institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë apo fusha të ndërlidhura me strehimin, Prefektët dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo subjekt tjetër publik që ushtron veprimtari në fushën e strehimit.

Pika 17 përcakton institucionet e ngarkuara me zbatimin e këtij projektakti. Së fundi parashikohet, në përputhje me Kushtetutën, se hyrja në fuqi e aktit është pas botimit në Fletore Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Kryeministri, Prefektët, ministri përgjegjës për strehimin, çështjet sociale dhe për çështjet vendore, si dhe shoqatat përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim u hartua në kuadrin e një bashkëpunimi midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) si ministria përgjegjëse për strehimin dhe UNDP-së, me asistencën e ekspertëve kombëtarë të kontraktuar nga UNDP-ja mbështetur në procedurat e UNDP-së.

Pranë MFE-së u ngrit grupi i punës me anëtarë nga stafi i MFE-së, i cili diskutoi intensivisht dhe konsultoi projektaktin paraprakisht në takime të vazhdueshme dhe periodike. Draftet e përgatitur nga ekspertë u rishikuan disa herë në takime të përbashkëta të grupit të punës. Grupi i punës dhe ekspertët analizuan edhe aktet nënligjore përkatëse që kanë mbuluar rregullimet e këtij projektvendimi për të konstatuar nga pikëpamja historike zhvillimin e rregullimit ligjor.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social” përcjell kosto shtesë financiare për të gjitha programet, të cilat do të përballohen nga buxheti qendror.

Lidhur me kostot institucionale, projektvendimi nuk kërkon ndryshim të numrit të të punësuarve pranë institucioneve të qeverisjes qendrore të ngarkuara me zbatimin e tij.

PROPOZUESI

MINISTRI